

5

Nazlije Cakolli

Edukatë muzikore

Për klasën e pestë të arsimit fillor



duk gjini
shtëpia botuese publishing house

Libri i mësuesit/es



PËRMBAJTJA

Plani vjetor.....	6
Plani dymujor: shtator—tetor.....	8
Plani dymujor: nëntor—dhjetor.....	12
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	19
Plani tremujor: prill—maj—qershor.....	26
Mësimi 1: Këngë: "Shkolla ime".....	33
Mësimi 2: Të rikujtojmë: shkalla C-dur dhe shkalla a-mol natyrale.....	36
Mësimi 3: Ushtrime: dinamika në muzikë.....	38
Mësimi 4: Kënga popullore në muzikën artistike.....	40
Mësimi 5: T'i njohim kompozitorët përmes dëgjimit - Miniatura për fëmijë.....	42
Mësimi 6: Veçoritë e tingullit dhe mjetet e audioincizimit.....	44
Mësimi 7: Këngë: "Er' e lehtë.....	47
Mësimi 8: Këngë: "Vjeshta" – Diezi.....	50
Mësimi 9: Këngë: "Rrjedh në këngë e ligjërime"	51
Mësimi 10: Këngë: "Festa e mësuesit dhe e mësueses"	53
Mësimi 11: Këngë: "Festa e nënës"	55
Mësimi 12: Këngë: "Që t' mos kemi kurrë pikëllim"	58
Mësimi 13: Këngë: "Ne po rritemi"	60
Mësimi 14: Këngë: "Dua të ha"	62
Mësimi 15: Masat e përziera.....	64
Mësimi 16: Këngët e atdhedashurisë si frymëzim për kompozitorët.....	66
Mësimi 17: T'i mësojmë instrumentet ritmike: trekëndëshi, lodra e vogël dhe defi.....	68
Mësimi 18: Këngë: "Urimi i Vitit të Ri"	70
Mësimi 19: Dëgjoni, këndoni dhe zbuloni gjëgjëzat muzikore.....	72
Mësimi 20: "Himni i flamurit" (Himni kombëtar shqiptar).....	74
Mësimi 21: Muzika e filmit.....	76
Mësimi 22: Këngë: "Përshëndetje shkollës".....	78
Mësimi 23: Masat e thjeshta 2/4, 3/4, 4/4.....	80
Mësimi 24: Ushtrime: gjej masat dhe plotëso.....	82
Mësimi 25: Të mësojmë: oboeja	84
Mësimi 26: Tripjesorja në poezi dhe në muzikë.....	86
Mësimi 27: Të mësojmë: kanoni.....	88
Mësimi 28: Instrumentet harkore	90
Mësimi 29: Çka është himni?.....	92
Mësimi 30: Llojet e koreve.....	94
Mësimi 31: Si e përjetojmë muzikën?.....	96
Mësimi 32: Orkestra harkore.....	98
Mësimi 33: Këngë: "Festa jonë"	101
Mësimi 34: Cili është roli i dirigjentit/es?	103
Mësimi 35: Të kujdesemi gjatë këndimit.....	105
Mësimi 36: Ndërtuesit e instrumenteve tradicionale.....	107
Mësimi 37: Saksofoni dhe krijimtaria e kompozitorëve tanë.....	109

Teksti Edukatë muzikore 5

Tekstin që nxënësi do ta ketë në duar, *Edukatë muzikore 5*, është përpiluar në pajtim të plotë me të gjitha kërkesat që përmban kurrikula e paracaktuar nga MASHT-i. Gjatë ndërtimit të konstruktit përmbajtjesor, jemi kujdesur që në tekst të përfshihen të gjitha temat që mundësojnë zhvillimin dhe ngritjen e mëtutjeshme të nxënësit në aspektin intelektual, kulturor, kombëtar, social etj.

Në mënyrë të veçantë, kemi pasur parasysh se nxënësi, në këtë stad të zhvillimit, tashmë ka filluar të njohë në mënyrë të vetëdijshme disa prej koncepteve bazë të teorisë së muzikës, andaj, në materien që ofron libri, vëzhgohet vazhdimësia e rrugës së filluar më parë. Është e qartë se tashmë nxënësi është i aftë t'i aplikojë konkretisht shumë nga njohuritë e përvetësuara më parë, por tani në mënyrë më kuptimplotë. Kështu, në fushën e njohjeve të koncepteve muzikore, teksti synon që ai të njohë edhe shkallët e reja muzikore, që të fitojë një vetëdije më të madhe teorike për notat muzikore dhe për shenjat e ndryshme muzikore, që për të do të jenë zgjerim i rëndësishëm i njohjes së gjuhës muzikore që është duke mësuar.

Në tekst nxënësi do të gjejë këngë të përshtatshme, përmes së cilave do të vazhdojë të kultivojë zhvillimin e aftësive për këndim të bukur, duke respektuar rregullat themelore të këndimit: qëndrimin e drejtë gjatë këndimit, këndimin e pastër intonativisht, të shqiptojë dhe të artikulojë qartë fjalët poetike të këngës, të aftësohet të këndojë në mënyrë individuale dhe sidomos të aftësohet me formën e këndimit grupor. Në këtë mënyrë, ai jo vetëm që do të zhvillojë kompetencat individuale, por nxënësi do të zhvillojë aftësinë për të bashkëpunuar me të tjerët. Kjo formë e këndimit është një aspekt i rëndësishëm i socializimit të tij, është njëri prej komponentëve më të rëndësishëm në botën e muzikës - performimi i përbashkët. Pa mëdyshje, këndimi, edhe më tutje, do të mbetet një prej aktiviteteve kyçe për kultivimin e dashurisë së tij për muzikën, që është një prej synimeve bazë të kësaj lënde mësimore.

Zgjedhja e veprave muzikore për dëgjim është bërë me kujdesin më të madh, meqë e konsiderojmë këtë segment mjaft të rëndësishëm, që do t'ia mundësojë nxënësit t'i zgjerojë edhe më shumë njohuritë e tij për muzikën, t'i njohë kompozitorët vendas dhe ata botërorë. Dëgjimi i muzikës duhet të shërbejë për nxënësin, që ai ta dashurojë më tepër muzikën, por në veçanti të kultivohet tek ai ndjenja dhe shprehja për të dëgjuar muzikë - aktivitet që është i rëndësishëm në pasurimin e jetës së tij emocionale dhe ngritjes së tij kulturore.

Zhvillimi i aftësive të nxënësit në luajtjen e instrumenteve mbetet, gjithashtu, një prej qëllimeve kryesore të librit. Shumica e këngëve të propozuara, njëkohësisht, mund të shoqërohen me instrumente, qoftë ato ritmike (përmes instrumenteve të ORF-it), instrumente melodike (blokflauti, në radhë të parë) apo edhe instrumente harmonike (si kitarra, pianoja etj.). Për shoqërimin e këtyre këngëve mund të shërbejnë instrumente që disponon shkolla, instrumente që posedojnë vetë nxënësit, por edhe instrumentet që nxënësit i ndërtojnë etj. Madje përmes zgjedhjeve dhe varianteve të ndryshme të aplikuara në përvetësimin e këngëve, zhvillohet njëkohësisht kreativiteti i nxënësit, aq shumë i nevojshëm për një të ri.

Autorja

		SHKOLLA:				
		PLANI VJETOR:				
		FUSHA E KURRIKULËS:		ARTET		
		KLASA:		V		
Lënda/lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2 (Klasa: V).	
	GJYSMËVJETORI I		GJYSMËVJETORI II			
	SHTATOR—TETOR	NËNTOR—DHJETOR	JANAR—SHKURT—MARS	PRILL—MAJ—QERSHOR	I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv 3, 4, 5, 6, 8
Lënda: Edukatë muzikore	Këngët	Këngët	Këngët	Këngët	II	Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 1, 2, 5
	Lojërat muzikore	Krijimet muzikore	Elementet bazike të gjuhës artistike	Instrumentet muzikore	III	Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm 1, 2, 4, 9
		Elementet bazike të gjuhës artistike	Elementet muzikore	Krijuesit dhe performuesit		
	Krijimet muzikore	Elementet muzikore	Format muzikore	Veprat artistike	IV	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv 3
		Shkrim- leximi	Llojet e muzikës	Ngjarjet artistike		
		Format muzikore			V	Kompetenca personale - Individ i shëndoshë 5, 8

					VI	Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 2, 5
Ekipi profesional						

	PLANI DYMUJOR:	SHTATOR—TETOR	
	VITI SHKOLLOR:		
	FUSHA E KURRIKULËS:	ARTET	
	LËNDA:	EDUKATË MUZIKORE	
	KLASA:	V	
Temat mësimore:	- Këngët - Lojërat muzikore - Krijimet muzikore		
RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:			
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv			
I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.			
I.4 Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.			
I.5 Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.			
Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ			
II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.			
Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm			
III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;			
III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;			
III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.			

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

- 1.1** Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).
- 1.2** Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.
- 1.5** Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.
- 1.6** Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.
- 2.1** Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
- 3.2** Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.
- 4.1** Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të tjerëve), duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Këngët Lojërat muzikore Krijimet muzikore	Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimit instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas	1. Të kujdesemi gjatë këndimit 2. Këngë: “Shkolla ime” 3. Ushtrime: dinamika në muzikë 4. Veçoritë e tingullit dhe mjetet e audioincizimit 5. Këngë: “Er’ e lehtë” 6. Këngë: “Vjeshta” – Diezi 7. Të mësojmë: kanoni	8	Mësimdhënia dhe të nxënët me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja; Mësimdhënia dhe të nxënët e diferencuar; Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca; Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar.	Vlerësim formativ	Gjuhë shqipe; Njeriu dhe natyra; Matematikë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; Edukim qytetar; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.	"Eduka të muzikore 5" CD 5

	instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative. Luan lojëra kreative të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor, forma, dinamika, tempi etj.). Improvizon me zë dhe instrumente muzikore (ritme e melodi); Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat, lojë-numërimet etj. Plotëson ritme e melodi në formën pyetje-përgjigje muzikore, me zë, instrumente dhe me notacion grafik/simbolik.	8. Këngë: “Rrjedh në këngë e ligjërimi”					
--	--	--	--	--	--	--	--

	PLANI DYMUJOR:	NËNTOR—DHJETOR	
	VITI SHKOLLOR:		
	FUSHA E KURRIKULËS:	ARTET	
	LËNDA:	EDUKATË MUZIKORE	
	KLASA:	V	
Temat mësimore:	Këngët Krijimet muzikore Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore		
RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:			
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë. I.4 Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.			

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.5 Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse;

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

RNF – Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimi (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

1.2 Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.

1.6 Krijon ritme e melodi me zë ose instrumente muzikore në bazë të ritmit ose tekstit poetik.

2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

Temat mësim-ore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndër-kurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Këngët	Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të	1. Të rikujtojmë: shkalla C-dur dhe shkalla a-mol natyrale 2. Këngë: “Dua të ha” 3. Këngët e atdhedashurisë si frymëzim për kompozitorët 4. “Himni i Flamurit” (Himni kombëtar shqiptar) 5. Dëgjoni, këndoni dhe zbuloni gjëgjëzat muzikore 6. Tripjesorja në poezi dhe në muzikë	8	Mësimdhënia dhe të nxënës në qendër dhe gjithë-përfshirja; Mësimdhënia dhe të nxënës e diferencuar; Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca;	Vlerësim formativ Vlerësim përmblendhës	Gjuhë shqipe; Njeriu dhe natyra; Matematikë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; Arsim për zhvillim të qëndrueshëm; Edukim qytetar.	"Edukatë muzikore 5" https://www.youtube.com/watch?v=kJORBPIILCa8

Krijimet muzikore	ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen.	7. Këngë: “Urimi i Vitit të Ri” 8. Vlerësim i njohurive		Mësimdhënia dhe të nxënëët e integruar.			
Elementet bazike të gjuhës artistike	Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me						
Elementet muzikore	vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksio-						

Shkrim leximi	neve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.						
Format muziko- re	Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëegjëzat, lojë- numërimet etj. Plotëson ritme e melodi në formën pyetje- përgjigje muzikore, me zë, instrumente dhe me notacion grafik/sim- bolik. Zbaton elementet						

themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur - mol)) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Zbaton notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikorë)) performimin dhe krijimin e shprehjes muzikore. Krahason dukuritë muzikore ritmike e						
---	--	--	--	--	--	--

	melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara. Vëren dhe dallon (me dëgjim) format muzikore më të thjeshta (kënga 2 dhe 3, tema me variacione, rondo, format e valleve etj.). Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3- pjesore të këngës.						
--	---	--	--	--	--	--	--

	PLANI TREMUJOR:	JANAR—SHKURT—MARS	
	VITI SHKOLLOR:		
	FUSHA E KURRIKULËS:	ARTET	
	LËNDA:	EDUKATË MUZIKORE	
	KLASA:	V	
Temat mësimore:	Këngët Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore Llojet e muzikës		
RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:			
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv			
I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.			
I.4 Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.			
I.5 Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.			

I.6 Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre, duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.

Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

1.2 Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore, sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.

1.5 Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin.

2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh., njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempin, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

3.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

3.2 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.

3.4 Dallon, krahason dhe prezanton krijues, performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike.

Temat mësim-ore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Këngët Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi	Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, që u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera.	1. Këngë: “Që t’mos kemi kurrë pikëllim” 2. Këngë popullore në muzikën artistike 3. Të mësojmë: oboeja 4. Masat e thjeshta 2/4, 3/4, 4/4 5. Masat e përziera 6. Gjej masat dhe plotëso 7. Çka është himni? 8. Këngë: “Festa e mësuesit dhe e mësueses” 9. Këngë: “Festa e Nënës” 10. Muzika e filmit	12	Mësimdhënia dhe të nxënësit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja; Mësimdhënia dhe të nxënësit e diferencuar; Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca; Mësimdhënia dhe të nxënësit e integruar.	Vlerësim formativ Vlerësim përmblendhës	Gjuhë shqipe; Njeriu dhe natyra; Matematikë; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; Edukim qytetar; Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.	"Edukatë muzikore 5" https://www.youtube.com/watch?v=UyB4-6g-Vbg

Format muzikore	Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike dhe tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen.						
Llojet e muzikës	Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative. Zbaton elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe (dur - mol)) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra						

muzikore që dëgjojnë. Vëren dhe dallon mënyrën e përdorimit të elementeve shprehëse muzikore për efekte të ndryshme në veprat muzikore (dramaticiteti, kontrasti, qetësia, lëvizja etj.). Zbaton notacionin muzikor bazik për gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikorë), për performim dhe krijim të shprehjes muzikore. Vëren dhe dallon (me dëgjim) format muzikore më të thjeshta (kënga 2 dhe 3, tema me							
---	--	--	--	--	--	--	--

variacione, rondo, format e valleve etj.). Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3-pjesore të këngës. Krahason elementet e përbashkëta dhe dalluese të llojeve të ndryshme të muzikës (muzika popullore, muzika artistike, muzika argëtuese/zbavitëse, muzikë filmi, teatri, baleti, vallëzimi etj.). Përzgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme në aktivitetet shkollore dhe							
--	--	--	--	--	--	--	--

	jashtë shkollës (shfaqje teatrale, dramë, projekt, revy etj.).						
--	---	--	--	--	--	--	--

	PLANI TREMUJOR:	PRILL—MAJ—QERSHOR	
	VITI SHKOLLOR:		
	FUSHA E KURRIKULËS:	ARTET	
	LËNDA:	EDUKATË MUZIKORE	
	KLASA:	V	
Temat mësimore:	Këngët Instrumentet muzikore Krijuesit dhe performuesit Veprat artistike Ngjarjet artistike		
RNK - Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:			
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë. I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ II.2 Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera). II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna. Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm Hssl.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.			

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyrë të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.3 Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

RNF - Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1 Këndon individualisht dhe në grup këngë e melodi, sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, futura, katrorë etj.).

1.2 Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole.

1.4 Luan në instrumente muzikore fëmijërore (të Orfit dhe popullore) sipas prirjes dhe mundësive interpretuese (muzike).

1.8 Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.

3.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

3.2 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike.

4.1 Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të të tjerëve), duke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës;

4.2 Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura, p.sh.: "Ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se... ai/ajo këndoi mirë me ritëm, por melodja nuk ishte e saktë etj."; "Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse..."; pra, me gjykim kritik për aq sa lejon moshën dhe aftësia e tyre përjetuese e veprave.

Krijuesit dhe performerit	lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen.	Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.					
Veprat artistike							
Ngjarjet artistike							
	Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj.						
		9. Instrumentet harkore 10. "Përshëndetje shkollës" 11. "Ne po rritemi"					

	Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike. Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj. Dallon instrumentet popullore të kulturave të ndryshme. Njeh mjetet audiovizuale për transmetim, incizim e ruajtje të muzikës. Njeh disa (10) krijues						
--	--	--	--	--	--	--	--

dhe performues nga veprat e dëgjuara muzikore.						
Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit; me lëvizje, me mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/ krijimet artistike vetjake dhe të të tjerëve me fjalor e terma adekuatë.						

	Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim. Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, shkollë, koncert, nga TV-ja etj.						
--	---	--	--	--	--	--	--

Fusha kurrikulare: Artet			Lënda: Edukatë muzikore			Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Këngët			Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.					
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3;II.5;III.4;III.9;VI.2.								
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,1.2								
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE								
Njësia mësimore: Këngë: “Shkolla ime” - fq. 9								
Fjalët kyçe: shkolla, zogu, qielli, hëna.								
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Mëson këngën; ● Këndon këngën; ● Shoqëron këngën me instrumente muzikore.								
Kriteret e suksesit: ● Mëson këngën pa gabime; ● Këndon këngën individualisht apo në grup sipas notacionit muzikor; ● Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.								
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, CD-ja, ndonjë vegël muzikore.								

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për shkollën, duke u ndërlidhur me përmbajtjen e tekstit të këngës.

Zhvillimi i mësimi - Duke u bazuar në libër, mësuesi/ja e lexon tekstin e këngës dhe bisedon në mënyrë të lirë me nxënësit.

Bashkëbisedohet me ta për këngën dhe këndimin, duke iu përgjigjur pyetjeve:

Kush i shkruan këngët?

Si shkruhen këngët?

Me çka i shoqërojmë këngët gjatë këndimit?

Çka duhet të kemi parasysh gjatë këndimit?

Para se të fillojë mësimi i këngës **“Shkolla ime”**, nxënësit e dëgjojnë incizimin e saj, me qëllim që ta ndiejnë bukurinë dhe karakterin e këngës. Me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike.

Kënga mësohet e ndarë në strofa, pastaj në tërësi.

*E bukur si hëna
e dashur porsi nëna
e pastër si burimi
është' si zog gëzimi*

*Ësht' kjo shkolla
shkolla ime
është' si zog gëzimi
Ësht' kjo shkolla
shkolla ime
është' si zog gëzimi*

*E ndritur si dielli
e lartë porsi qielli
e fortë porsi trimi
e bardh' si agimi*

U kërkohet nxënësve që këngën ta përcjellin me instrumentet e Orfit.

U shpërndaheh nga një fletë në të cilën secili e paraqet mesazhin e këngës. Mesazhet lexohen para grupit.

Pjesa përfundimtare - Nxënësit mund ta këndojnë këngën të ndarë në grupe ose mund ta këndojnë me ndarje tjetër (solisti e këndon pjesën e parë të këngës dhe pastaj refrenin e këndon tërë klasa).

Bashkëbisedohet lidhur me shenjat që shihen në libër: **allegro** - shpejt/ **p** - qetë / **il** - shenja e përsëritjes.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara. Vlerësimi formativ: nxënësi/ja në fund të orës shqipton drejt tekstin e këngës me ritëm dhe në këtë mënyrë fillon aftësia dhe ndjenja për ritëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Temat: Elementet bazike të gjuhës artistike	Rezultatet e të nxënit të temës: Zbaton elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur - mol)) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në vepra të tjera muzikore që dëgjojnë. Zbaton notacionin muzikor bazik, gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikorë) për performim dhe krijim të shprehjes muzikore.	
Elementet muzikore		
Shkrim-leximi		
Format muzikore		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.5, V.5, V.8, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 2.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Të rikujtojmë: shkalla C-dur dhe shkalla a-mol natyrale - fq. 12		
Fjalët kyçe: vargu, shkalla, tingulli.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Dallon shkallën C-dur nga A-mol; ● Paraqet notat në pentagram; ● Këndon notat e paraqitura në pentagram.		
Kriteret e suksesit: ● Paraqet të gjitha dallimet e shkallës C-dur dhe A-mol në Diagramin e Venit; ● Paraqet saktë notat në pentagram, duke u bazuar në shembujt në tekst; ● Zbaton notacionin e notave të paraqitura në pentagram.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, fletë A4.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit lidhur me notën **Do** dhe shkallën **C-dur**. Rikujtohet se vargu i dhënë me nota muzikore quhet *shkallë* dhe, meqë fillon nga nota **Do** dhe përfundon me notën **Do**, quhet shkalla **C-dur**.

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet skemën e mëposhtme. Detyrë e nxënësve është që të gjejnë të përbashkëtat dhe dallimet në mes të shkallës **C-dur** dhe **A-mol**.



Secili nxënës, në mënyrë individuale, e plotëson skemën e përgatitur nga mësuesi/ja. Lexohen disa prej tyre.

Zhvillimi i mësimi - Hapen librat dhe analizohen detyrat e paraqitura aty. Nxënësit i këndojnë notat që janë në pentagram. Detyrë e tyre është që t'i lexojnë paragrafët e paraqitur dhe t'i vendosin fjalët që mungojnë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexojnë.

Pjesa përfundimtare - Nxënësit kanë për detyrë që të paraqesin në pentagramin e tyre shembujt e paraqitur në libër. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara. Vlerësim formativ: nxënësi zhvillon të kënduarit me tekst dhe me nota muzikore, duke njohur shkallën C-dur dhe A-mol.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Krijimet muzikore		Rezultatet e të nxënit të temës: Improvizon me zë dhe instrumente muzikore (ritme e melodi). Plotëson ritme e melodi në formën pyetje-përgjigje muzikore, me zë, instrumente dhe me notacion grafik/simbolik.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 1.6.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Ushtrime: dinamika në muzikë - fq. 19		
Fjalët kyçe: simbol, dinamikë, vizatim.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Emërton simbolet e paraqitura; ● Vizaton simbolet në kuti, sipas ritmit; ● Argumenton emrin dhe simbolin.		
Kriteret e suksesit: ● Emërton saktë simbolet e paraqitura, duke plotësuar njëri-tjetrin; ● Vizaton bukur dinamikën në kuti, sipas ritmit; ● Argumenton rrjedhshëm vendosjen e simbolit pranë emrit.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, libër.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për tingujt e zëshëm/fuqishëm, të qetë, të lartë etj.		
Shpjegohet se këto në gjuhën muzikore njihen si: forte (fuqishëm), piano (e qetë), mezoforte (fuqi mesatare) etj. Bëhet fjalë për dinamikën. Gjatë interpretimit, fuqinë e zërit gradualisht		
mund ta ngremë - që ndryshe quhet dhe njihet si <i>crescendo</i>  ose edhe ta ulim - <i>decrescendo</i>  .		

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet në projektor disa simbole. Detyrë e nxënësve është që t'i emërtojnë ato:

f *ff* *Pp* *mp* *P* *mf* *Mf*

Nxënësit e plotësojnë njëri-tjetrin.

Zhvillimi i mësimi - Te kjo pjesë e orës mësimore plotësohet libri.

Aktiviteti 1. Emërtojnë dhe shkruajnë kuptimet e simboleve.

Aktiviteti 2. Vëzhgojnë me kujdes simbolet dhe vizatojnë në kuti dinamikën, në bazë të tyre.

Aktiviteti 3. Shkruajnë kuptimet e tyre. Analizohen detyrat e nxënësve.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja shpërndan në grupe simbolet, emrat e tyre dhe ushtrimin e përgatitur nga ai/ajo. Ushtrimi është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë nxënësit i vendosin simbolet, kurse në pjesën e dytë emrat e tyre. Vlerësohet grupi fitues.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, identifikon zërat: *forte* (fuqishëm), piano (e qetë), mezo*forte* (mesatare) dhe dinamikën e tyre. Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Llojet e muzikës		Rezultatet e të nxënit të temës: Krahason elementet e përbashkëta dhe dalluese të llojeve të ndryshme të muzikës (muzika popullore, artistike, argëtuese/zbavitëse, muzikë filmi, teatri, baleti, vallëzimi etj.). Përzgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme në aktivitetet shkollore dhe jashtë shkollës (shfaqje teatrale, dramë, projekt, revy etj.).
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, I.5, II.1, III.1.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 3.4.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Kënga popullore në muzikën artistike - fq. 66		
Fjalët kyçe: valle, popullore, trashëgimi.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Bashkëbisedon për fotografinë; ● Dallon vallen popullore nga vallet e tjera; ● Përzgjedh vallen. Kriteret e suksesit: ● Emërton saktë atë që paraqet fotografia; ● Liston të gjitha elementet që tregojnë për vallen popullore; ● Përzgjedh këngën të shoqëruar me valle, të cilën do ta mësojë për ta interpretuar.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libër, CD.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm, Edukim qytetar.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Paraqitet përmes videoprojektorit një fotografi dhe diskutohet ajo së bashku me nxënësit.		



Nxënësit mësojnë se populli ynë ka trashëguar pasuri të madhe të këngëve, të cilat me shekuj janë krijuar prej rapsodëve popullorë, zakonisht të panjohur, andaj edhe quhet muzikë popullore.

Zhvillimi i mësimi - Mësuesi/ja do t'u shpjegojë nxënësve se muzika popullore është e pasur në llojllojshmërinë e saj dhe se ajo krijohet nga vetë populli.

Aktiviteti 1. Nxënësit gjejnë këngë që janë kënduar dikur e që këndohen edhe sot. Secili grup prezanton punën.

Aktiviteti 2. Nxënësit gjejnë disa nga kompozimet e Mendi Mengjiqit.

Mendi Mengjiqi lindi më 1958, në Lupç të Podujevës. Kompozoi shumë vepra për instrumente solo, për kor dhe vepra të mëdha për orkestër. Veprat më të rëndësishme të tij janë: "Sonata për trio frymor", "Valle për 5 perkusionistë dhe piano", "Shota për 6 perkusione", "Oratoriumi për solistë vokalë, Kor dhe Orkestër", "Homazh për Nënë Terezën". Një ndër veçoritë e veprave të Mendi Mengjiqit është mbështetja në muzikën popullore shqipe, sikurse që e gjejmë në veprën "Gjirokastrite", kompozuar për piano (4 duar).

Aktiviteti 3. Nxënësit mësojnë se **"Vallet popullore rumune"** është suitë prej gjashtë pjesësh të shkurtra për piano, të kompozuar nga Bela Bartoku, në vitin 1915. Ky cikël bazohet në shtatë melodi rumune nga Transilvania, të luajtura fillimisht në fyellin e bariut.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit dëgjojnë këngë të shoqëruara me valle popullore, përzgjedhin njëren prej tyre, të cilën do ta interpretojnë para të tjerëve. Pyeten nxënësit nëse e dëgjojnë muzikën popullore dhe u kërkohet t'i thonë disa emra të këngëtarëve që këndojnë këngë popullore dhe që ata i njohin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE


Nxënësi/ja në fund të orës njihet me dinamikën dhe tingujt e muzikës popullore. Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Krijuesit dhe performuesit	Rezultatet e të nxënit të temës: Njih disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjuara muzikore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.2, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: T'i njohim kompozitorët përmes dëgjimit - Miniatura për fëmijë - fq. 17		
Fjalët kyçe: kompozitor, vepër, historik.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Dëgjon veprën muzikore; • Shkruan për historikun e kompozitorit; • Përzgjedh kompozitorin kosovar.		
Kriteret e suksesit: • Emërton saktë kompozitorin e veprës së dëgjuar; • Liston së paku dy të dhëna për historikun dhe veprat e tij; • Argumenton me një përmbledhje të shkurtër përzgjedhjen e kompozitorit.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD, libër.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet përmes videoprojektorit veprën A-mol për piano solo, e quajtur “Für Elise” apo “Për Elisën”, një nga pjesët më të njohura të kompozitorit Ludwig van Beethoven (linku: https://www.youtube.com/watch?v=wFF0zHeU3Zs). Nxënësit mësojnë se kjo vepër në A-mol për piano solo, e quajtur “Për Elisën”, është një nga pjesët më të njohura të kompozitorit Ludwig van Beethoven. Kjo vepër u zbulua 40 vjet pas vdekjes së tij. Miniatura për piano kanë shkruar edhe kompozitorë të tjerë, siç është Bela Bartoku, i cili përshkroi <i>Mikrokosmos</i> si një cikël prej 153 miniaturash për piano. Ato janë të shkruara nën ndikimin e muzikës popullore hungareze.		
Zhvillimi i mësimi - Nxënësit punojnë në grupe. Mësuesi/ja në secilin grup shpërndan fotografinë e Ludwig van Beethoven-it. Detyrë e tyre është që të shkruajnë për historikun dhe veprat muzikore të tij.		

L.V. Beethoven është kompozitor i madh gjerman. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Vjenë, duke fituar popullaritet të madh. Atë e adhuronin për muzikën e bukur që kompozonte, megjithëse nga natyra ishte i vrullshëm dhe hidhërak. Shkroi vepra të formave të ndryshme, si: sonata, koncerte, vepra kamertale etj. Famën e arriti sidomos me 9 simfonitë e tij të famshme. Meqë ishte edhe dirigjent, shpesh i dirigjonte veprat e veta në shfaqje publike. Sa ishte në kulm të krijimtarisë së tij, Beethoveni e kuptoi se shqisa e të dëgjuarit po i dobësohej dhe se së shpejti nuk do të dëgjonte fare. Megjithatë, deri në fund të jetës krijoi pandërprerë. Ndër veprat e shumta pianistike, ai shkroi edhe kompozimin e popullarizuar “Für Elise” (“Për Elisën”).



Hulumtimi do të bëhet rreth krijimtarisë së kompozitorëve nga Kosova dhe Shqipëria dhe dëgjimi i miniaturave nga kompozitorët tanë vendorë. Prezantohet puna e secilit grup.

Pjesa përfundimtare - Pyeten nxënësit se a u ka pëlqyer kjo vepër muzikore, si e përjetuan dhe çfarë ndien gjatë të dëgjuarit. Ata përzgjedhin njërin nga kompozitorët nga Kosova, të cilët janë të paraqitur në projektor. Bisedojnë për shembuj të tjerë muzikorë, si dhe për autorët tanë, të cilët po ashtu kanë shkruar një mori veprash të shkurtra apo miniatura për piano.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumton për kompozitorë vendorë. Nxënësi do të fillojë ta njohë literaturën e muzikës klasike.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Lojërat muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Luan lojëra kreative, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor, forma, dinamika, tempi etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.4, III.4, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Veçoritë e tingullit dhe mjetet e audioincizimit - fq. 14		
Fjalët kyçe: i lartë, i ulët, i hollë, i trashë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Jep mendim për tingullin; ● Tregon llojin e tingullit; ● Diskuton për tingullin.		
Kriteret e suksesit: ● Jep së paku një mendim për veçoritë e tingullit; ● Emërton saktë llojin e tingullit të paraqitur në kërkesë; ● Argumenton nëse tingulli mund të paraqitet me fjalë apo jo.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Matematikë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja vizaton një rreth dhe brenda tij shkruan: *Veçoritë e tingullit*. Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh.



Zhvillimi i mësimi - Te kjo pjesë e orës mësimore hapet libri. Analizohen detyrat e paraqitura në libër. Nxënësit punojnë në grupe.

Aktiviteti 1. Nxënësit tregojnë se me cilin lloj të tingujve kemi të bëjmë:



tingujve kemi të bëjmë:



Aktiviteti 2. Nxënësit tregojnë se me cilin lloj të

Aktiviteti 3. Nxënësit duhet të tregojnë se sipas kujt kategorizohen tingujt. Prezantohet puna e secilit grup. Ata mësojnë se, në muzikë, shenjat e dinamikës do të na ndihmojnë ta përcaktojmë intensitetin (forcën) e tingullit.

Në vazhdim, nxënësit do të pyeten nëse njohin **mjetet e audioincizimit**. Si mund t'i incizojmë dhe ruajmë tingujt tanë? Nxënësve do t'u shpjegohet se tingujt mund të incizohen përmes mikrofonave dhe pastaj përmes programeve muzikore mund të editohen (ndryshohen). Veprat që ata dëgjojnë janë incizuar paraprakisht. Në këtë formë do të ruajmë këto incizime, do t'i përdorim për gjeneratat e reja.

Pyeten nxënësit:

A mund të tregoni se cilat janë mënyrat e tjera të incizimit dhe cilat janë pajisjet e tjera që mund të përdorim?

Bashkërisht, me ndihmën e telefonave apo mikrofonave, në rast se shkolla disponon, mund të incizohen tinguj të ndryshëm dhe analizohen valët e tyre tingëllore në programe të ndryshme muzikore (si *pro tools, cakewalk, cubase, sound forge* etj.).

Në vazhdim, krijohet **libraria** me tingujt e incizuar në klasë, të cilët mund të shfrytëzohen për ndonjë punim.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë të tregojnë nëse mund t'i përshkruajnë tingujt me fjalë. Nxënësit punojnë në grupe. Pas përfundimit, prezantohet puna e secilit grup.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Japin shembuj nga jeta e përditshme për llojin e tingujve.


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Artet		Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë mund të përfshihen.		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3;II.5;III.4;III.9;VI.2.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këngë: “Er’ e lehtë” - fq. 20			
Fjalët kyçe: era, malli, vendi, fshati.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Mëson këngën duke dëgjuar; ● U përgjigjet pyetjeve të parashtruara; ● Paraqet këngën në pentagram.			
Kriteret e suksesit: ● Këndon sipas notacionit muzikor këngën e mësuar; ● U përgjigjet saktë të gjitha pyetjeve; ● Paraqet këngën në pentagram sipas kërkesave të dhëna.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektori, pentagrami, fletë A4.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Aftësim për zhvillim të qëndrueshëm.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse

Harta e mendimeve

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan “Era”. Detyrë e nxënësve është që të tregojnë se çfarë dinë për erën. Mendimet e nxënësve shkruhen në skemën e mëposhtme.



Mësuesi/ja secilit nxënës në mënyrë individuale i shpërndan të njëjtën skemë. Detyrë e nxënësve është që ta plotësojnë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre lexohen.

Zhvillimi i mësimit

Mësojmë me ndalesa

Dëgjohet kënga me ndalesa. Nxënësit së bashku këndojnë strofën e parë, duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë këngën.

Pyetjet:

1. *Për kë i ngjall mall era?*
2. *Kush ia kujton begatinë e malit?*

Nxënësit së bashku këndojnë strofën e dytë, duke e përcjellë atë që dëgjojnë. Përsëritet disa herë derisa ta përvetësojnë këngën.

3. *Si ishte era e verës?*
4. *Kush e zgjon natyrën?*

Mendimet e nxënësve diskutohen.

Pjesa përfundimtare

Në pentagram, të paraqesin këngën me notat muzikore. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përgjigjeve, paraqitjen e këngës në pentagram dhe këndimin sipas notacionit muzikor.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në pentagram paraqesin këngën me notat muzikore.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Edukatë muzikore Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: “Vjeshta” - Diezi - fq. 25		
Fjalët kyçe: vjeshta, shenja para notave.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Mëson këngën; ● Këndon këngën; ● Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: ● Mëson këngën pa gabime; ● Këndon këngën individualisht apo në grup sipas notacionit muzikor; ● Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për stinën e vjeshtës dhe bukurinë e saj. Parashtrohen disa pyetje për të nxitur diskutimin:

Sa stinë ka viti?

Sa muaj përfshin secila stinë?

Në cilën stinë bien gjethet?

Në cilën stinë natyra është e artë?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke e plotësuar njëri-tjetrin. Njoftohen me rregullat gjatë këndimit.

Te kjo pjesë e orës mësimore hapen librat.

- Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “Vjeshta” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë nëse nuk ka projektor).
Lëshohet kënga në CD dhe e dëgjojnë me vëmendje interpretimin e këngës.
- Nxënësit, me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa dhe pastaj mësohet kënga në tërësi.
- Mësuesi/ja do të kërkojë nga nxënësit që këngën ta përcjellin me instrumentet e Orfit.

Në vazhdim, nxënësit do të njoftohen me shenjën e diezit. Mësuesi/ja do t’u shpjegojë se diezi # e ngre tingullin për gjysmë tingulli. Nëse diezi shënohet para notës, atëherë vlen vetëm për atë notë ose për tërë masën. Në rast se shënohet pas çelësit, atëherë kjo do të vlejë për tërë këngën.

Nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Po ashtu, do të dëgjojnë veprën korale të kompozitorit kosovar Lorenc Antoni, të quajtur “Vjeshta”.

Analizohen detyrat e nxënësve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE


Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Edukatë muzikore Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5;III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: “Rrjedh në këngë e ligjërime” - fq. 43		
Fjalët kyçe: atdhedashuria, Shqipëria, pavarësia.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Mëson këngën; ● Këndon këngën; ● Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: ● Mëson këngën pa gabime; ● Këndon këngën individualisht apo në grup sipas notacionit muzikor; ● Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathhtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm, Edukim qytetar.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet në projektor fotografinë e kompozitorit Feim Ibrahimit. Detyrë e nxënësve është që ta analizojnë dhe të tregojnë emrin e kompozitorit të paraqitur. Parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.



Si quhet kompozitori që shihni në fotografi?

Autor i cilave vepra është?

Në cilën datë festohet pavarësia e Republikës së Kosovës?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke e plotësuar njëri-tjetrin. Njoftohen me rregullat gjatë këndimit.

Feim Ibrahim është ndër kompozitorët më të njohur shqiptarë. Është personalitet që ka kontribuar shumë në zhvillimin dhe organizimin e jetës muzikore në Shqipëri. Është autor i veprave të shumta solistike, kamertale dhe orkestrale. Është autor i muzikës për shumë filma.

Te kjo pjesë e orës mësimore, hapen librat.

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “Rrjedh në këngë e ligjërime” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë nëse nuk ka projektor).

Pastaj, kënga e ndarë në strofa paraqitet në tabelë. E mësojmë këngën në tërësi.

Aktiviteti 2: Lëshohet kënga në CD, dëgjojmë me vëmendje interpretimin e këngës.

Aktiviteti 3: Mësuesi/ja do të kërkojë nga nxënësit që këngën ta përcjellin me instrumentet e Orfit.

Aktiviteti 4: Nxënësit tregojnë se çfarë tregojnë shenjat sipër notave.

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit në grupe kanë për detyrë që të krijojnë një poezi të shkurtër, së cilës, më pas, do t’ia shtojnë edhe melodinë. Varësisht prej kohës, disa prej tyre prezantohen.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Artet

Lënda: Edukatë muzikore

Shkalla e kurrikulës: II

Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Këngë: “Festa e mësuesit dhe e mësueses” - fq. 47	
Fjalët kyçe: shkolla, mësuesja, nëna, festa.	
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Mëson këngën; ● Këndon këngën; ● Shoqëron këngën me instrumente muzikore. Kriteret e suksesit: ● Mëson këngën pa gabime; ● Këndon këngën individualisht apo në grup, sipas notacionit muzikor; ● Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.	

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm, Edukim qytetar.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja i pyet nxënësit se si do ta përshkruanin personin më të dashur të tyre dhe çka ata vlerësojnë më shumë te ai person.

Mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin:

Në cilin muaj jemi?

Çfarë festa kemi në muajin mars?

Pse festohet 7 Marsi?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke plotësuar njëri-tjetrin. Njoftohen me rregullat gjatë këndimit.

Te kjo pjesë e orës mësimore, hapen librat.

Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “Festa e mësuesit dhe e mësueses” paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë nëse nuk ka projektor).

Para se të fillojë mësimi i këngës, nxënësit e dëgjojnë incizimin e këngës, me qëllim që ta ndiejnë bukurinë dhe karakterin e saj. Ata, me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa dhe pastaj mësohet në tërësi.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që këngën ta përcjellin me instrumentet e Orfit.

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që ta përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: “Festa e Nënës” - fq. 52		
Fjalët kyçe: nëna, festa, dashuria.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Mëson këngën; ● Këndon këngën; ● Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: ● Mëson këngën pa gabime; ● Këndon individualisht apo në grup sipas notacionit muzikor; ● Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja e lexon tekstin, më pas nxënësit e dëgjojnë këngën nga CD-ja. Gjithashtu, mësuesi/ja do ta shqiptojë tekstin e këngës me ritmin që ka kënga. Nxënësit, para se ta mësojnë melodinë e saj, e shqiptojnë tekstin e këngës duke u bazuar në libër.

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja e paraqet skemën e mëposhtme me projektor.

1. Kush? Nëna

2. Si është? _____

3. Çfarë bën? _____

4. Një fjali me 4 fjalë.

5. Një emër ndryshe (një sinonim) _____

Të njëjtën skemë mësuesi/ja ia shpërndan secilit nxënës. Skema plotësohet në bashkëpunim me nxënësit. Varësisht prej kohës, lexohen disa prej tyre.

Te kjo pjesë e orës mësimore, hapen librat.

- Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Festa e nënës**” paraqitet përmes projektorit.
- Para se të fillojë mësimi i këngës, nxënësit e dëgjojnë incizimin e saj, me qëllim që ta ndiejnë bukurinë dhe karakterin e këngës. Me ndihmën e mësuesit/es, ata fillojnë ta mësojnë këngën: në bazë të veprimeve standarde metodologjike, kënga mësohet e ndarë në strofa dhe pastaj në tërësi.

Kush na përk’dhel

Me dashuri

Kush ne na flet

Me ëmbëlsi

E ka emrin nën’

*Kush ne na thot’
o shpirti im
drita e syve
sjell veç agim
e ka emrin nën’*

*Dora e ngroht’
Na lumturon
Me fjal’n e saj
Ne fluturojm’*

*Tik-taku i zemrës
Troket me ne
Ti na mësove
Fjalën atdhe!*

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që këngën ta përcjellin me instrumentet e Orfit.

Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit në grupe kanë për detyrë që të shkruajnë një poezi për nënën dhe pastaj të krijojnë melodinë, duke i radhitur notat. Këtë këngë mund t’ua bëjnë dhuratë nënave të tyre, duke ua bashkëngjitur edhe fotografitë e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet		
Lënda: Edukatë muzikore		
Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: “Që t’mos kemi kurrë pikëllim” - fq. 57		
Fjalët kyçe: pikëllim, gëzim, natë, zabel.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Mëson këngën; • Këndon këngën; • Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: • Mëson këngën pa gabime; • Këndon këngën individualisht apo në grup, sipas notacionit muzikor; • Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja parashtroi disa pyetje për të nxitur diskutimin:

A keni qenë ndonjëherë të pikëlluar? Kur?

Çfarë ju bën që të ndiheni të pikëlluar?

Çfarë bëni në ato momente? Si e tejkaloni pikëllimin?

Hapen librat.

Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli **“Që t’mos kem kurrë pikëllim”** paraqitet përmes projektorit (titulli shkruhet në tabelë nëse nuk ka projektor).

Para se të fillojë mësimi i këngës “Që t’mos kem kurrë pikëllim”, nxënësit e dëgjojnë incizimin e saj, me qëllim që ta ndiejnë bukurinë dhe karakterin e këngës. Me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa, pastaj në tërësi.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që këngën ta përcjellin me instrumentet e Orfit. Në këtë pjesë të orës mësimore, ata kanë për detyrë që ta përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e nxënësve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es e me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: “Ne po rritemi” - fq. 69		
Fjalët kyçe: sytë, lumturi, ndryshim.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Mëson këngën; • Këndon këngën; • Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: • Mëson këngën pa gabime; • Këndon këngën individualisht apo në grup sipas notacionit muzikor; • Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm, Edukim qytetar.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtrohet disa pyetje për të nxitur diskutimin.

Kush kujdeset për ju?

Me kalimin e viteve, çfarë ka ndryshuar te ju?

Kush është personi më i dashur për ju?

Cilat lojëra keni luajtur dikur?

Si është fëmijëria juaj?

Zhvillimi i mësimi - Te kjo pjesë e orës mësimore hapen librat.

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Ne po rritemi**” paraqitet përmes projektorit ose shkruhet në tabelë.

Para se të fillojë mësimi i këngës “Ne po rritemi”, nxënësit e dëgjojnë incizimin e këngës, me qëllim që ta ndiejnë bukurinë dhe karakterin e saj.

Me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa, pastaj mësohet në tërësi. Njëri nxënës bëhet solist, kurse të tjerët në kor vazhdojnë këngën.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që këngën ta përcjellin me instrumentet e Orfit.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: "Dua të ha" - fq. 81		
Fjalët kyçe: ushqim, shëndet, fruta.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Mëson këngën; • Këndon këngën; • Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: • Mëson këngën pa gabime; • Këndon këngën individualisht apo në grup, sipas notacionit muzikor; • Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin.

A ju pëlqejnë frutat?

Cila është fruta juaj e preferuar?

Cilat vitamina përmban fruta juaj e preferuar?

A ke në oborrin e shtëpisë sate ndonjë frutë të mbjellë?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke plotësuar njëri-tjetrin. Njoftohen me rregullat gjatë këndimit.

Zhvillimi i mësimit - Te kjo pjesë e orës mësimore, hapen librat.

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Dua të ha**” paraqitet përmes projektorit ose shkruhet në tabelë.

Para se të fillojë mësimi i këngës “Dua të ha”, nxënësit e dëgjojnë incizimin e këngës, me qëllim që ta ndiejnë bukurinë dhe karakterin e saj.

Me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa, pastaj në tërësi.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që këngën ta përcjellin me instrumentet e Orfit.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Temat: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Zbaton elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur - mol)) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3-pjesore të këngës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.5, V.5, V.8, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Masat e përziera - fq. 55		
Fjalët kyçe: nota, takti, masa.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Bashkëbisedon me të tjerët; ● Paraqet notat në pentagram; ● Praktikon taktet e paraqitura.		
Kriteret e suksesit: ● U përgjigjet saktë pyetjeve të parashtruara; ● Përshkruan saktë taktet e notave në pentagram; ● Praktikon saktë me duar taktet e paraqitura në pentagram.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin:		

- Çfarë është masa?
- Nga çfarë përbëhet masa?
- Cilat janë masat e thjeshta?
- Cilat janë masat e përziera?

Mësuesi/ja ua rikujton nxënësve se, nëse i bëjmë bashkë një rrokje të theksuar e një të patheksuar, fitojmë një MASË. Masat shënohen me një vijë vertikale. Masa e përbërë prej një pjese të theksuar dhe prej një pjese të patheksuar quhet **masë dypjesore**.

Në vazhdim, nxënësit mësojnë se masat e përziera janë të përbëra prej llojeve të ndryshme të masave. Pjesa më e madhe e këngëve tona popullore është e sajuar pikërisht në këto lloje masash.

Masat e përziera janë: 5/8, 7/8, 9/8 etj. Masa e përzier 9/8 është e përbërë prej masave 4/8 dhe 5/8.

Nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram taktet e notave që janë paraqitur në libër.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit praktikojnë me instrumente të Orfit shembujt e paraqitur në libër.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Edukatë muzikore Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Krijuesit dhe performuesit	Rezultatet e të nxënit të temës: Njeh disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjuaara muzikore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.2, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngët e atdhedashurisë si frymëzim për kompozitorët - fq. 64		
Fjalët kyçe: frymëzim, kompozitor, atdhedashuri.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Diskuton me tjetrin; • Vëzhgon me kujdes fotografitë e kompozitorëve; • Prezanton punën e grupit; • Dëgjon këngën.		
Kriteret e suksesit: • Jep së paku një mendim rreth pyetjes së parashtruar; • Bashkon saktë fotografitë me emrat e kompozitorëve; • Prezanton rrjedhshëm punën e grupit, duke treguar prejardhjen e kompozitorit; • Arsyeton me pak fjalë frymëzimin e kompozitorëve nga kjo këngë.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografitë, teksti.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja parashtron një pyetje për të nxitur diskutimin: - A dini ndonjë këngë kushtuar vendit apo historisë sonë? Nxënësit në dyshe mendojnë rreth pyetjes së parashtruar dhe përgjigjen.		
Zhvillimi i mësimi - Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit lidhur me këngët tona popullore të atdhedashurisë apo këngët që lartësojnë figurat tona kombëtare. U shpjegohet nxënësve se kompozitorët shumë shpesh janë frymëzuar nga muzika jonë popullore për të krijuar vepra të mëdha orkestrale. Kënga popullore “Qenkan mbushur malet me borë” është njëra prej këngëve		

më frymëzuese për kompozitorët tanë, si p.sh.: **Fahri Beqiri, Çesk Zadeja**. Ajo ka shërbyer si temë bazë për krijimin e veprave të mëdha për orkestër.

Po ashtu, mund të diskutohet për kompozitorët e tjerë ndërkombëtarë, të cilët po ashtu kanë gjetur frymëzimin e tyre në këngët burimore të vendeve të tyre, p.sh., kompozitori Jean Sibelius. Populli finlandez ende e mban muzikën e tij afër zemrës.

Nxënësit pyeten nëse njohin këngë të tjera që kanë shërbyer si frymëzim për vepra të tjera orkestrale apo kamertale.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore nxënësit dëgjojnë këngën popullore “Qenkan mbushur malet me borë”. Kjo këngë është njëra prej këngëve më frymëzuese për kompozitorët tanë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Instrumentet muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj. Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor, mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj. Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.8, II.5, III.4, IV.3, VI.5.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 1.8.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: T'i mësojmë instrumentet ritmike: trekëndëshi, lodra e vogël dhe defi - fq. 33		
Fjalët kyçe: lodra, trekëndëshi, instrumenti, defi.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Diskuton me tjetrin për instrumentet; • Ndërton instrumente; • Përshkruan instrumentin e krijuar.		
Kriteret e suksesit: • Identifikon saktë instrumentet e paraqitura në projektor; • Përdor materiale të ndryshme për të krijuar instrumentet; • Përshkruan me fjalë krijimin e instrumenteve, duke treguar formën, materialin, tingullin që lëshon.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: materiale të ndryshme, si shtagëza, lugë, tekst.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Kontribuues produktiv, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, ore mësuesi/ja paraqet përmes videoprojektorit disa instrumente muzikore (https://www.youtube.com/watch?v=2-LQWBSq43U). Diskutohet së bashku me nxënësit videoja e paraqitur.		

Zhvillimi i mësimit - Te kjo pjesë e orës mësimore hapet libri. Nxënësit punojnë në grupe. Në secilin grup vendosen materialet e marra nga shtëpia. Detyrë e secilit grup është që të punojnë trekëndëshin, lodrën e vogël dhe defin me materiale ricikluese. Pastaj, një përfaqësues i grupit përshkruan me fjalë krijimin e instrumenteve, duke treguar formën, materialin, tingullin që prodhon.

Nxënësit luajnë ushtrimet me instrumentet e punuara. Mund të merren këngë që janë punuar më herët apo edhe ushtrime të tjera ritmike/melodike.

Grupi i parë - trekëndëshi zëvendësohet me shtagëza, lugë;

Grupi i dytë - lodra e vogël zëvendësohet me shuplaka.

Kërkesë:

Provo që këngët t'i këndosh me përcjellje të instrumenteve ritmike, të cilat i ke mësuar dhe të cilat më së miri u përshtaten këngëve (me trekëndësh ose lodër të vogël).

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Temat: Veprat artistike Ngjarjet artistike	Rezultatet e të nxënit të temës: hpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit; me lëvizje, me mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetjake dhe të të tjerëve me fjalor e terma adekuatë. Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim. Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike, të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV-ja etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: "Urimi i Vitit të Ri" - fq. 37		
Fjalët kyçe: Viti i Ri, gëzim, festë, dhuratë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Dëgjon këngën; ● Përshkruan këngën; ● Vlerëson punimin e shokut/shoqes.		
Kriteret e suksesit: ● Shpreh emocionet e veta me fjalë lidhur me këngën; ● Paraqet përmbajtjen e këngës me anë të vizatimit; ● Argumenton vlerësimin e dhënë për performancën e paraqitur përmes vizatimit.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin:

- Cili ka qenë urimi yt i fundit për Vitin e Ri?
- Si ndiheni ju kur afrohen festat e fundvitit?
- Cila ishte dhurata që more herën e fundit?
- Kush ta solli dhuratën?
- A i ke bërë dikujt ndonjë dhuratë?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke e plotësuar njëri-tjetrin.

Te kjo pjesë e orës mësimore, hapen librat.

Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Urime Viti i Ri**” paraqitet përmes projektorit. Dëgjohet kënga me vëmendje, pastaj secili nxënës i paraqet emocionet e veta gjatë dëgjimit të këngës.

E dëgjojnë incizimin e këngës, me qëllim që ta ndiejnë bukurinë dhe karakterin e saj.

Me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa, pastaj në tërësi.

Njoftohen nxënësit se përmbajtjen e këngës do ta paraqesin përmes vizatimit.

Në telin e tharjes, ata formojnë turin e galerisë, ku secili nxënës për zgjedh punimin e shokut/shoqes, të cilin do ta vlerësojë.

Në këtë pjesë të orës, nxënësit argumentojnë me fjalë vlerësimin e dhënë për krijimin e punimit të shokut/shoqes.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Krijimet muzikore		Rezultatet e të nxënit të temës: Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëegjëzat, lojë-numërimet etj. Plotëson ritme e melodi në formën pyetje-përgjigje muzikore, me zë, instrumente dhe me notacion grafik/simbolik.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 1.6.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Dëgjoni, këndonin dhe zbuloni gjëegjëzat muzikore - fq. 38		
Fjalët kyçe: krijim, ritëm, gjëegjëzë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Bashkëbisedon me tjetrin për gjëegjëzat; ● Dëgjon me vëmendje gjëegjëzat; ● Paraqet në pentagram gjëegjëzat. Kriteret e suksesit: ● Emërton saktë gjëegjëzat gjatë bashkëbisedimit; ● Radhit saktë gjëegjëzat e dëgjuara; ● Paraqet saktë në pentagram njërin nga gjëegjëzat.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libër, CD.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin: - Çfarë janë gjëegjëzat? - A dini ju ndonjë gjëegjëzë? Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke e plotësuar njëri-tjetrin. Prezantohen disa nga gjëegjëzat e nxënësve.		
Zhvillimi i mësimi - Te kjo pjesë e orës mësimore, hapen librat. Analizohen gjëegjëzat e paraqitura në pentagram. Aktiviteti 1. Nxënësit i dëgjojnë me vëmendje melodinë e tekstin, si dhe i zgjidhin gjëegjëzat.		

Aktiviteti 2. Mësojnë gjëegjëzat muzikore sipas radhës.

Aktiviteti 3. Radhisin gjëegjëzat, sipas dëgjimit dhe kërkesës së mësuesit/es.

Pas dëgjimit me vëmendje të gjëegjëzave, të ndara për dëgjim nga mësuesi/ja, plotësojnë sipas radhitjes që dëgjojnë.

1 _____

2 _____

3 _____

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram gjëegjëzat e mësuara. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përzgjidh tri gjëegjëza në internet.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es e me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: "Himni i flamurit" (Himni kombëtar shqiptar) - fq. 29		
Fjalët kyçe: himni, flamur, festë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Mëson këngën; ● Këndon këngën; ● Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: ● Mëson këngën pa gabime; ● Këndon këngën individualisht apo në grup, sipas notacionit muzikor; ● Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukim qytetar.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet përmes videoprojektorit himnin kombëtar shqiptar (linku: <https://www.youtube.com/watch?v=kJORBPILCa8>).

Diskutohet së bashku me nxënësit videoja e paraqitur. Mësojnë, ndër të tjera, se në cilat raste dëgjohet himni kombëtar shqiptar dhe cilat rregulla duhen zbatuar.

Po ashtu, gjatë orës mund të diskutohet lidhur me himnin e Kosovës. Nxënësit pyeten nëse e njohin atë dhe kush është autori i tij.

Zhvillimi i mësimit - Hapen librat.

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Himni i flamurit**” paraqitet përmes projektorit ose shkruhet në tabelë.

Me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa dhe më pas në tërësi.

Lëshohet kënga në CD, dëgjojmë me vëmendje interpretimin e këngës.

Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: një nxënës këndon këngën, kurse të tjerët e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me instrumente të Orfit.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Llojet e muzikës		Rezultatet e të nxënit të temës: Krahason elementet e përbashkëta dhe dalluese të llojeve të ndryshme të muzikës (muzika popullore, artistike, argëtuese/zbavitëse, muzikë filmi, teatri, baleti, vallëzimi etj.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, I.6, II.1, III.4, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Muzika e filmit - fq. 62		
Fjalët kyçe: film, muzikë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Emërton llojet e muzikës; ● Tregon filmin e parapëlqyer; ● Dallon muzikën e filmit nga llojet e tjera të muzikës.		
Kriteret e suksesit: ● Plotëson të gjithë katrorët me llojet e muzikës; ● Tregon mesazhin e filmit të pëlqyer; ● Liston së paku dy elemente që e dallojnë muzikën e filmit nga llojet e tjera.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukim qytetar.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja vizaton një rreth dhe brenda tij shkruan: *Llojet e muzikës*. Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh.



Zhvillimi i mësimimit - Te kjo pjesë e orës mësimore, hapen librat dhe analizohen paragrafët e paraqitur aty.

Aktiviteti 1. Nxënësit tregojnë filmin e tyre më të preferuar.

Aktiviteti 2. Flasin për përmbajtjen dhe muzikën e tij. Secili e prezanton punën e bërë.

Pjesa përfundimtare - Nxënësit e dëgjojnë këngën “Let it go”, këngë në filmin “Frozen”. Ajo është një nga këngët më të popullarizuara në historinë e filmit, e cila ka fituar shumë çmime, duke u bërë një nga këngët më të pëlqyera nga fëmijët në botë. Nxënësit listojnë elementet që e dallojnë muzikën e filmit nga llojet e tjera të muzikës. Ato lexohen dhe shkruhen në tabelë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumton për muzikën e filmit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es e me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: “Përshëndetje shkollës” - fq. 88		
Fjalët kyçe: shkolla, lamtumirë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Mëson këngën; • Këndon këngën; • Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: • Mëson këngën pa gabime; • Këndon këngën individualisht apo në grup sipas notacionit muzikor; • Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja vizaton një rreth dhe brenda tij shkruan: *Shkolla*. Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh.



Nxënësit me ndihmën e mësuesit/es fillojnë ta mësojnë këngën në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa, pastaj në tërësi.

Lëshohet kënga në CD, dëgjojmë me vëmendje interpretimin e këngës.

Njoftohen se kënga këndohet sipas rregullave: një nxënës këndon këngën, kurse të tjerët e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me instrumente të Orfit.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Zbaton elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur - mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3-pjesore të këngës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.5, V.5, V.8, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Masat e thjeshta 2/4, 3/4, 4/4 - fq. 22		
Fjalët kyçe: masë, vlerë, notë, dykohëshe, trekohëshe, katërkohëshe.		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • U përgjigjet pyetjeve të parashtruara; • Takton masën; • Tregon vlerat e notave katërshe.		
Kriteret e suksesit: • U përgjigjet saktë pyetjeve të parashtruara; • Takton masat e ndonjëres nga këngët që i pëlqen; • Tregon saktë vlerat e dy, tri dhe katër notave katërshe.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektori, laptopi.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse

Nxënësve u drejtohen pyetjet:

- *Çfarë është masa?*
- *Kush e përbën masën?*
- *Pse vendosen dy vija në fund të melodisë?*

Diskutohet rreth përgjigjeve të nxënësve.

Zhvillimi i mësimit

Dëgjohet kënga me ndalesa. Pas çdo ndalese, mësimezhënësi/ja nxënësve u drejton pyetje rreth përmbajtjes së këngës.

Shënojnë nga dy shembuj ritmikë për secilën masë.

Provojnë këngë që dinë t'i taktojnë.

Vërejnë masën e shënuar pas çelësit dhe taktojnë.

Pjesa përfundimtare

Pastaj, në çifte nxënësi udhëzohet të taktojë njërin nga këngët, kurse shoku/shoqja tregon se cila është vlera e notave dy, tri apo katër notave katërshe (ato që i dëgjon).

Nxënësit tregojnë se sa lëvizje bëjnë masat dykohëshe dhe cila është vlera e dy notave katërshe.

Nxënësit tregojnë se sa lëvizje bëjnë masat trekohëshe dhe cila është vlera e tri notave katërshe.

Nxënësit tregojnë se sa lëvizje bëjnë masat katërkohëshe dhe cila është vlera e katër notave katërshe.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përgjigjeve, identifikimin e vlerës së notës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Në pentagram, të paraqesin një këngë, duke përfshirë masat dykohëshe, trekohëshe dhe katërkohëshe.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Temat: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Zbaton notacionin muzikor bazik (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore, 7 tingujt muzikorë) për performim dhe krijim të shprehjes muzikore. Vëren dhe dallon mënyrën e përdorimit të elementeve shprehëse muzikore për efekte të ndryshme në veprat muzikore (dramaticiteti, kontrasti, qetësia, lëvizja etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.5, V.5, V.8, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 2.1		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Ushtrime: gjej masat dhe plotëso - fq. 23		
Fjalët kyçe: masë, hapësirë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Dallon elementet shprehëse muzikore të këngës; • Këndon këngën; • Paraqet këngën në pentagram.		
Kriteret e suksesit: • Liston së paku njërin nga elementet shprehëse, si: dramaticitetin, kontrastin, qetësinë, lëvizjen pas dëgjimit të këngës; • Këndon këngën me notacion muzikor bazik, duke përdorur gjatësinë dhe lartësinë tingëllore; • Paraqet saktë këngën në pentagram.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD, libër, pentagram.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron disa pyetje për të nxitur diskutim: - Si quhet hapësira që zë vend mes dy vijave vertikale? - Nga çfarë përbëhet masa?		

- Çfarë shënohet në fund të melodisë?

Zhvillimi i mësimi - Te kjo pjesë e orës mësimore, hapen librat.

Nxënësit kanë për detyrë që t'i plotësojnë zbrazëtitë që gjenden në partiturë. Përmes vlerave të sakta të notave, ata do të plotësojnë këto zbrazëti. Njëkohësisht, ata do të ndërtojnë melodi.

Në fund, që mësimi të jetë edhe më atraktiv, mund të thurri vargje që do t'i shtohen melodisë së krijuar.

Bashkë mund të këndojnë këngët e kompozuar nga shokët dhe shoqet e tjerë të klasës. Këngët mund të shoqërohen me instrumentet e ndërtuara më parë apo edhe me instrumentet që disponon shkolla.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e tyre.


VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Edukatë muzikore Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Instrumentet muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: - Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike), përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre; - Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.5, III.4, IV.3, VI.5.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 1.8.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Të mësojmë: oboeja - fq. 75		
Fjalët kyçe: instrument, identifikim.		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • U përgjigjet pyetjeve të parashtruara; • Identifikon kafshën me instrumentin muzikor; • Vizaton kafshën me instrumentin me të cilën identifikohet.		
Kriteret e suksesit: • U përgjigjet pyetjeve të parashtruara, duke u bazuar në shfaqjen e shikuar; • Identifikon saktë kafshën me instrumentin muzikor; • Vizaton kafshën e parapëlqyer me instrumentin që identifikohet.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fleta A4, projektori, CD, laptop.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Aftësim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan “Oboeja”. Detyrë e nxënësve është që të tregojnë se çfarë dinë për oboe. Mendimet e nxënësve shkruhen në skemën e mëposhtme.		



Secili nxënës në mënyrë individuale plotëson të njëjtën skemë. Disa prej tyre lexohen.

Zhvillimi i mësimit

Mësuesi/ja fillimisht shfaq veprën “Pjetri dhe ujku”.

(<https://www.youtube.com/watch?v=px8FakwGPDM>). Nga nxënësit kërkohet që ta vështrojnë me kujdes videon e paraqitur dhe më pas parashtrohen pyetje:

- Me kë identifikohet macja?
- Me kë identifikohet zogu?
- Me kë identifikohet rosa?

Diskutohen mendimet e nxënësve.

Pjesa përfundimtare

Vizatojnë kafshët dhe mjetet muzikore më të cilat identifikohen. Puna e tyre monitorohet dhe ndihmohet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përgjigjeve dhe identifikimin e instrumentit me kafshën dhe vizatimin e kafshës së parapëlqyer me mjetin muzikor të identifikuar.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumton ndonjë kafshë tjetër për ta identifikuar me ndonjë mjet muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Temat: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim-leximi Format muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Zbaton notacionin muzikor bazik (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore - 7 tingujt muzikorë) për performim dhe krijim të shprehjes muzikore. Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3-pjesore të këngës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4, II.5, V.5, V.8, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 2.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Tripjesorja në poezi dhe në muzikë - fq. 46		
Fjalët kyçe: pjesa e parë, pjesa e dytë, ABA.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Bashkëbisedon me tjetrin për këngën; ● Këndon këngën; ● Krijon melodi të thjeshtë.		
Kriteret e suksesit: ● U përgjigjet saktë pyetjeve gjatë bashkëbisedimit për formën e këngës; ● Këndon këngën me notacionin bazik muzikor; ● Krijon një melodi të thjeshtë 3-pjesore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libër, CD.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për formën muzikore. Në muzikë ka këngë dy dhe tripjesore dhe ndryshe ato quhen edhe A (pjesa e parë), B (pjesa e dytë). Në rast se pjesa e parë A përsëritet, atëherë do ta kemi këngën tripjesore ABA. Zhvillimi i mësimi - Notat muzikore dhe gjatësia e tyre në libër sqarohen dhe komentohen. Për ta pasur më të qartë, nxënësit shkruajnë notat te grafiku i notave që të këndojnë më lehtë. Fillohet me këndimin e notave së bashku, duke përsëritur disa herë. Ndërsa për ta kuptuar formën muzikore më lehtë, gjatë orës mund të zhvillohet një lojë. Përmes dëgjimit, nxënësit do		

ta vërejnë melodinë e pjesës së parë (A) dhe do të sillen bashkë në rreth. Në momentin që dëgjojnë ndryshimin, melodinë e pjesës së dytë (B), ata ulen të gjithë.

Zhvillimi i mësimit - Te kjo pjesë e orës mësimore hapen librat.

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “Viti i Ri” paraqitet përmes projektorit ose shkruhet në tabelë.

Me ndihmën e mësuesit/es fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa, pastaj në tërësi.

Lëshohet kënga në CD, dëgjojmë me vëmendje interpretimin e saj.

Njoftohen nxënësit se kënga këndohet sipas rregullave: një nxënës këndon këngën, kurse të tjerët e shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me instrumente të Orfit.

Pjesa përfundimtare - Kërkohet nga nxënësit të këndojnë me nota duke shikuar në libër, njëherë në grupe e pastaj tërë klasa. U kërkohet që të krijojnë një melodi, të cilën do të mundohen edhe ta këndojnë. Mësojnë se si në poezi, ashtu edhe në muzikë, forma mund të ndryshojë. Në këtë rast, forma tripjesore përbëhet nga tri pjesë, ku pjesa e parë dhe e treta janë të njëjta. Që ta kemi më të qartë se si bëhet kjo ndarje, do ta shohim shembullin “Viti i Ri”. Analizojmë së bashku ndarjen e këngës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Lojërat muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Luan lojëra kreative, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor, forma, dinamika, tempi etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.2, 4.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Të mësojmë: kanoni - fq. 74		
Fjalët kyçe: dyzanor, programi, nxënësit, paraqitja skenike.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Bashkëbisedon; ● Vëzhgon ushtrimet e tekstit; ● Këndon meloditë e tekstit.		
Kriteret e suksesit: ● Jep së paku një mendim rreth pyetjes së parashtruar “Çka kupton me fjalën <i>kanon</i>?”; ● Përshkruan saktë në pentagram njërin nga ushtrimet e tekstit; ● Këndon me ritëm melodinë e tekstit sipas kanonit.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: pentagrami, teksti, CD.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron një pyetje për të nxitur diskutim. Pyeten nxënësit:		
Çfarë kuptoni me fjalën <i>kanon</i> ?		
Mësojnë se kanoni është kompozim dyzanor apo më shumë. Të gjithë zërat (linjat melodike) e këndojnë melodinë e njëjtë, me vonesë të caktuar. Imitacioni duhet të jetë në vendin ku është i caktuar, nëse duam që tërë kompozimi të tingëllojë mirë.		

Zhvillimi i mësimit - Në këtë pjesë të orës mësimore, hapen librat.

Pjesa përfundimtare - Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit e mësojnë melodinë duke kënduar bashkërisht, të ndarë në dy, tri apo katër grupe. Çdo grup këndon nga vendi ku e ka të shënuar numrin e vet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Bashkë me prindërit apo ndonjë të rritur tjetër, kërkon në internet informacione për kanonin.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Edukatë muzikore Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Instrumentet muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.8, II.5, II.4, IV.3, VI.5.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Instrumentet harkore - fq. 70		
Fjalët kyçe: viola, violina, violonçeli.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Tregon instrumente muzikore; • Bashkon fotografitë me emrat e instrumenteve; • Vizaton instrumentet harkore; • Punon në grup.		
Kriteret e suksesit: • Liston të gjitha instrumentet muzikore që njeh; • Çiftëzon saktë emrin e instrumentit me fotografinë e tij; • Vizaton bukur instrumentet harkore, duke u bazuar në ngjyrën, madhësinë, formën që kanë. • Merr pjesë aktive në realizimin e detyrave të dhëna.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja parashtron një pyetje për të nxitur diskutim: <i>A dini ndonjë instrument harkor?</i> Nxënësit punojnë në dyshe. Prezantohet puna e përfunduar. Mësojnë se instrumentet harkore janë: violina, viola, violonçeli, kontrabasi.		
Zhvillimi i mësimi - Analizohen fotografitë dhe paragrafët e dhënë në libër. Në secilin grup shpërndahen fotografitë dhe emrat e instrumenteve harkore. Nxënësit në grupe çiftëzojnë fotografitë me emrin e instrumentit që i takon. Puna e përfunduar prezantohet.		

Pjesa përfundimtare - Nxënësit i vizatojnë instrumentet harkore dhe i analizojnë punimet e njëri-tjetrit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Bashkë me prindërit apo ndonjë të rritur tjetër, kërkojnë në internet informacione për kore të ndryshme dhe i dëgjojnë shembujt.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es e me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Çka është himni? - fq. 30		
Fjalët kyçe: himni, festa, vlerë, simbol.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • I përgjigjet pyetjes së parashtruar për himnin; • Dallon himnin kombëtar dhe shtetëror; • Dëgjon me vëmendje dy lloje të himnit. Kriteret e suksesit: • I përgjigjet saktë pyetjes se çfarë është himni; • Argumenton me fjalë dallimin mes himnit kombëtar dhe shtetëror; • Këndon sipas rregullave himnin kombëtar ose shtetëror.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD, libër.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja i pyet nxënësit: *Çfarë është himni?* Në dyshe e mendojnë përgjigjen e pyetjes. Nxënësit i përgjigjen pyetjes së parashtruar. Mësojnë se himni është kënga apo melodia zyrtare e një shteti. Ai bart shumë vlera që lidhen me historinë e kombit.

Zhvillimi i mësimit - Te kjo pjesë e orës mësimore hapen librat. Nxënësit dëgjojnë “Himnin e Kosovës” dhe “Himnin e Flamurit”. Në grupe e bëjnë krahasimin e himneve të dëgjuara. Ata duhet të gjejnë edhe autorët që i kanë shkruar tekstet e dy himneve. Nxënësit analizojnë paragrafin *Asdreni dhe Rilindja Kombëtare*, si dhe komentojnë përmbajtjen e tij. Prezantohet puna e secilit grup.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja i pyet nxënësit se në cilat raste këndohet himni kombëtar; si qëndrojmë kur këndohet ai etj. Ata u përgjigjen pyetjeve të parashtruara dhe e plotësojnë njëri-tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Krijuesit dhe performuesit		Rezultatet e të nxënit të temës: Njih disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjua muzikore.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.2, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Llojet e koreve - fq. 48		
Fjalët kyçe: kori, dirigjenti.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Jep mendim për llojet e koreve; • Njihet me punën e korit; • Bashkëbisedon për funksionimin e koreve.		
Kriteret e suksesit: • Plotëson saktë të gjithë skemën me llojet e koreve; • Liston rregullat e punës së korit; • Arsyeton funksionimin e koreve.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libër, fotografi të llojeve të koreve.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukimi qytetar.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja vizaton një rreth dhe brenda tij shkruan: <i>Llojet e koreve</i> . Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh.		
<pre> graph TD A([Llojet e koreve]) --> B[Kore për fëmijë] A --> C[Kori i përzier] A --> D[] A --> E[] </pre>		

Zhvillimi i mësimit - Në videoprojektor shfaqen këto këngë: **Thoma Simaku**: “Trëndëlinë” - kor i femrave (linku: <https://www.youtube.com/watch?v=GKuj9Ullvdk>), **Vaso S. Tole**: “Ç’u mbush mali me dëborë” - kor i përzier dhe **Bahri Mulliqi**: “O bylbyl i mjerë” - kor i përzier. Pas dëgjimit, nxënësit duhet të tregojnë cilit lloj të koreve i takon secila këngë. Zhvillohet një bashkëbisedim me ta.

I analizojnë paragrafët e paraqitur në libër. **Mësojnë se kori** përbëhet prej një grupi të këngëtarëve që këndojnë bashkërisht në mënyrë të organizuar. Korin e udhëheq dirigjenti. Dallohen disa lloje të koreve: kori i fëmijëve, kori i meshkujve, kori i femrave, kori i përzier. Diskutohet edhe për Thoma Simakun dhe veprat e tij.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit duhet t’i gjejnë përgjigjet e pyetjeve që janë në libër.

- *A ka kor shkolla jote?*
- *Nëse po, a këndohen këngët korale dy apo trezëshe?*
- *Përmend ndonjë kor që ke dëgjuar në koncert, radio, televizor apo diku tjetër.*

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke e plotësuar njëri-tjetrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Bashkë me prindërit apo ndonjë të rritur tjetër, kërkon në internet informacione për kore të ndryshme.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Temat: Veprat artistike Ngjarjet artistike		Rezultatet e të nxënit të temës: Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike, të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV-ja etj.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3;II.5;III.4;III.9;VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Si e përjetojmë muzikën? - fq. 56		
Fjalët kyçe: emocion, dëshirë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Plotëson skemën; ● U përgjigjet pyetjeve.		
Kriteret e suksesit: ● Plotëson saktë skemën rreth muzikës; ● U përgjigjet saktë të gjitha pyetjeve të parashtruara.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet skemën e mëposhtme me projektor.		
1. Kush? Muzika 2. Si është? _____ 3. Çfarë bën? _____ 4. Një fjali me 4 fjalë. _____ 5. Një emër ndryshe (një sinonim) _____ Skema plotësohet në bashkëpunim me nxënësit. Lexohen disa prej tyre. Zhvillimi i mësimit - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja shpërndan secilit nxënësit ushtrimin e përgatitur. Ushtrimi është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë të ushtrimit janë të		

vendosura pyetjet e dhëna në libër. Detyrë e nxënësve është që t'i gjejnë përgjigjet e pyetjeve dhe t'i shkruajnë në pjesën tjetër të ushtrimit. Pas përfundimit, lexohen disa prej tyre.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja dhe nxënësit flasin pak për këngët dhe muzikën që pëlqejnë apo që dëgjojnë, varësisht prej disponimit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ese për muzikën që i pëlqen.


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Instrumentet muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj. Dallon instrumentet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor, mënyra e interpretimit, ansambleve që u përkasin etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.8, II.5, III.4, IV.3, VI.5.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 4.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Orkestra harkore - fq. 72		
Fjalët kyçe: orkestër, harkore, instrument, emocion.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Jep mendim për orkestrën harkore; • Vëzhgon fotografitë e paraqitura; • Dëgjon muzikë nga kompozitorë të ndryshëm.		
Kriteret e suksesit: • Plotëson saktë skemën për orkestrën harkore; • Emërton saktë fotografitë me grupet e instrumenteve; • Shpreh emocionet me fjalë, duke përshkruar muzikën e dëgjuar.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: CD, libër.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja vizaton një rreth dhe brenda tij shkruan: *Orkestra harkore*. Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh.



Zhvillimi i mësimit - Nxënësit mësojnë se shumë kompozitorë kanë shkruar për orkestër harkore, si: Vivaldi, Moxarti, Çajkovski, Briteni etj. Nga kompozitorët shqiptarë, vepra për orkestër harkore kanë shkruar: Rexho Mulliqi, Zeqirja Ballata, Feim Ibrahim, Mendi Mengjiqi, Baki Jashari, Valton Beqiri, Drinor Zymberi etj.



Në secilin grup shpërndahet fotografia e mëposhtme. Nxënësit në grupe i emërtojnë grupet e instrumenteve harkore, siç janë:

- violinat e para;
- violinat e dyta;
- violat;
- violonçelat;
- kontrabasët.

Pas përfundimit, secili grup prezanton punën e vet.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit dëgjojnë **V. A. Mozartin**: “Muzikë e vogël nate” për orkestër harkore dhe **Drinor Zymberin**: “Simfonieta” për orkestër harkore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Bashkë me prindërit apo ndonjë të rritur tjetër, kërkon në internet për informacione rreth instrumenteve harkore.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Edukatë muzikore Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e A-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësuesit/es e me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Këngë: “Festa jonë” - fq. 85		
Fjalët kyçe: festë, dita e fëmijëve.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Mëson tekstin e këngës; ● Këndon këngën; ● Shoqëron këngën me instrumente muzikore.		
Kriteret e suksesit: ● Mëson këngën pa gabime; ● Këndon këngën individualisht apo në grup, sipas notacionit muzikor; ● Shoqëron këngën me zë, me duar apo me vegla muzikore.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tekst, CD, ndonjë vegël muzikore.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja vizaton një rreth dhe brenda tij shkruan: *1 Qershori*. Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh.



Zhvillimi i mësimit

Aktiviteti 1: Nxënësit njoftohen me këngën që do ta mësojnë. Titulli “**Festa jonë**” paraqitet përmes projektorit ose shkruhet në tabelë.

Nxënësit me ndihmën e mësuesit/es fillojnë ta mësojnë këngën, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa, më pas në tërësi.

Lëshohet kënga në CD, e dëgjojmë me vëmendje interpretimin e këngës.

Njoftohen se kënga këndohet sipas rregullave: një nxënës këndon këngën, kurse të tjerët shoqërojnë me duar. Nxënësit individualisht dhe në grup këndojnë këngën e mësuar, duke e shoqëruar me zë dhe me instrumente të Orfit.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit kanë për detyrë që të përshkruajnë në pentagram këngën e mësuar. Analizohen detyrat e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Interpreton këngën me një instrument muzikor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Krijuesit dhe performuesit		Rezultatet e të nxënit të temës: Njih disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjua muzikore.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.2, VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 3.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Cili është roli i dirigjentit/es? - fq. 31		
Fjalët kyçe: dirigjent, kosovar, botëror.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Jep mendime për dirigjentin; • Njih dirigjentët botërorë dhe kosovarë; • Përshkruan rolin e dirigjentit.		
Kriteret e suksesit: • Plotëson saktë skemën për dirigjentin; • Bashkon saktë fotografitë me emrat e dirigjentëve botërorë dhe kosovarë; • Argumenton rolin e dirigjentit.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libër, fotografi.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Mësuesi/ja vizaton një rreth dhe brenda tij shkruan: <i>Dirigjenti</i> . Mendimet e nxënësve shkruhen në secilin drejtkëndësh.		
<pre> graph TD D((Dirigjenti)) --> U[Udhëheq orkestrën] D --> Z[Zgjedh veprat] D --> B1[] D --> B2[] D --> B3[] </pre>		

Zhvillimi i mësimit - Te kjo pjesë e orës mësimore paraqitet në videoprojektor videoja me disa nga dirigjentët botërorë (linku: https://www.youtube.com/watch?v=z_yIn8V3UcU).
Analizohet dhe diskutohet së bashku me nxënësit.

Hapen librat dhe analizohen lëvizjet dhe paragrafët me emrat e disa dirigjentëve botërorë: Herbert von Karajan, Zubin Mehta, Mirga Gražinytė-Tyla etj.
Nxënësit mësojnë se edhe Kosova ka pasur dhe ka dirigjentë të mirëfilltë. Ata duhet të gjejnë emrat e dy prej tyre. Prezantohet puna e disa prej nxënësve.

Pjesa përfundimtare - Në këtë pjesë të orës mësimore, nxënësit punojnë në grupe. Në secilin grup, mësuesi/ja i shpërndan fotografitë dhe emrat e dirigjentëve botërorë dhe të Kosovës. Detyrë e nxënësve është që t'i përshtatin fotografitë me emrat e dirigjentëve që u takojnë. Secili grup prezanton punën e përfunduar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumton për një dirigjent kosovar dhe një botëror.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Edukatë muzikore Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Këngët	Rezultatet e të nxënit të temës: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe), sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur e a-mol). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre, si dhe u përkasin tematikave që mund të ndërlidhen me lëndët e tjera. Edhe këngët popullore shqipe, me vlerë artistike e tekst të përshtatshëm për këtë moshë, mund të përfshihen. Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësuesit/es e me notacion simbolik dhe në mënyrë kreative.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; III.9; VI.2.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Të kujdesemi gjatë këndimit - fq. 10		
Fjalët kyçe: rregull, këngë.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: ● Vëzhgon me vëmendje fotografitë; ● U përgjigjet pyetjeve të shpërndara; ● Këndon këngën e përzgjedhur.		
Kriteret e suksesit: ● Përcakton qëndrimin e drejtë gjatë këndimit, përmes fotografive; ● U përgjigjet saktë me shkrim pyetjeve të shpërndara; ● Këndon këngën e përzgjedhur, duke u bazuar në rregullat e këndimit.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libër, projektor.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Edukim qytetar.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse - Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja paraqet në projektor një fotografi. Detyrë e nxënësve është që ta analizojnë:



Parashtron disa pyetje për të nxitur diskutimin, si për shembull:

Çfarë po shihni në fotografi?

Si është ulur djaloshi në fotografinë e parë?

Si është ulur djaloshi në fotografinë e dytë?

Po ju, si uleni në karrige?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke e plotësuar njëri-tjetrin.

Zhvillimi i mësimi - Mësuesi/ja ia shpërndan ushtrimin e përgatitur secilit nxënës. Në mënyrë individuale, ata e plotësojnë ushtrimin e përgatitur nga mësuesi/ja e tyre. Ushtrimi duhet të jetë i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë janë të vendosura pyetjet, kurse në pjesën e dytë duhen vendosur përgjigjet e pyetjeve të parashtruara. Detyrë e nxënësve është që t'i gjejnë përgjigjet e pyetjeve të parashtruara:

Si duhen mbajtur trupi, qafa dhe fytyra gjatë këndimit? A është frymëmarrja veprim i rëndësishëm në këndim? Çfarë duhet të keni parasysh gjatë këndimit? etj. Nxënësit e prezantojnë punën e tyre.

Pjesa përfundimtare - Nxënësit përzgjedhin një këngë dhe e këndojnë duke u bazuar në rregullat e këndimit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për angazhimin në aktivitetet e zhvilluara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


Liston rregullat e këndimit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Edukatë muzikore Shkalla e kurrikulës: II		
Tema: Instrumentet muzikore		Rezultatet e të nxënit të temës: Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike; - Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.8, II.5, III.4, IV.3, VI.5.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 1.8.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Ndërtuesit e instrumenteve tradicionale - fq. 39		
Fjalët kyçe: instrument, krijues, tradicional.		
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • U përgjigjet pyetjeve të parashtruara; • Ndërton instrumentin; • Emërton instrumentet frymorë.		
Kriteret e suksesit: • U përgjigjet saktë pyetjeve të parashtruara; • Ndërton instrumentin, duke ndjekur hapat e dhënë; • Emërton saktë instrumentet frymorë.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, projektori, gazeta, ngjitësi, letra me ngjyra, lapsi.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Aftësim për zhvillim të qëndrueshëm.		

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit skemën e mëposhtme. Brenda rrethit shkruan “Instrumentet frymore tradicionale”. Detyrë e nxënësve është që të tregojnë se çfarë dinë për instrumentet frymore. Mendimet e nxënësve shkruhen në skemën e mëposhtme.



Secili nxënës në mënyrë individuale plotëson të njëjtën skemë. Disa prej tyre lexohen.

Zhvillimi i mësimit

- Cilat janë instrumentet tradicionale?
- Kush i ndërton instrumentet?
- Prej cilit material ndërtohen instrumentet?
- A mund të ndërtoni ju ndonjë instrument?

Po, si? Jo, pse?

Pas përgjigjeve që japin nxënësit, mësuesi/ja shfaq për disa minuta në videoprojektor videon me hapat e krijimit të fyellit.

(https://www.youtube.com/watch?v=_ccgr7vgk-8). Nxënësit duhet që ta vështrojnë me kujdes videon e paraqitur. Udhëzohen nxënësit që të krijojnë instrumentin. Puna e nxënësve vëzhgohet dhe ndihmohet.

Pjesa përfundimtare

Secilit nxënës i shpërndahet ushtrimi me instrumente frymore. Detyrë e nxënësve është që t'i gjejnë emrat e instrumenteve dhe t'i ngjyrosin ato. Nxënësit bëjnë turin e galerisë dhe komentojnë rreth elementeve të përdorura në krijim.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për saktësinë e përgjigjeve dhe për emërtimin e instrumenteve dhe krijimin e instrumentit muzikor.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punojnë ndonjë instrument tjetër frymor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e kurrikulës: II
Tema: Instrumentet muzikore	Rezultatet e të nxënit të temës: Dallon instrumentet të kulturave të ndryshme; Krjon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.8, II.5, III.4, IV.3, VI.5.		
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 4.2.		
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE		
Njësia mësimore: Saksofoni dhe krijimtaria e kompozitorëve tanë - fq. 78		
Fjalët kyçe: instrument, saksofon, instrumente muzikore, vepra artistike.		
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: • Jep mendime rreth instrumenteve; • Përzgjedh material për punë; • Bashkëbisedon për instrumentet e krijuara.		
Kriteret e suksesit: • Emërton disa nga instrumentet muzikore; • Dallon instrumentet përmes tingujve; • Zhvillon shprehje për dëgjim muzikor.		
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: instrumente të ndryshme, libër.		
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.		
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE		
Pjesa hyrëse - Pyeten nxënësit nëse u kujtohen veprat që i kanë dëgjuar në klasat e mëparshme dhe instrumentet e mësuara. Cili është instrumenti që ata preferojnë dhe nëse ata luajnë në ndonjë prej këtyre instrumenteve.		
Zhvillimi i mësimi - Nxënësit mësojnë për saksofonin, i cili është instrument frymor. U shpik më 1840, nga Antoine-Joseph Adolphe Sax, krijues i famshëm i instrumenteve të tunxhit. Ai lindi në qytetin Dinant të Belgjikës. Saksofonin e gjejmë, para se gjithash, në muzikën xhaz, në		

rock dhe muzikën pop, kurse më pak në muzikën klasike. Për saksofon kanë shkruar kompozitorë, si: Berliozi, Rosini, Raveli, Glazunovi.

Pjesa përfundimtare - Pas prezantimit të saksofonit, dëgjohej shembulli muzikor nga kompozitori ynë, i cili ka shkruar vepra pikërisht për këtë instrument, Valton Beqiri: "Folk-Suita" për saksofon e piano.

Veprat e kompozitorit **Valton Beqiri** shquhen për një frymë bashkëkohore, të cilat gjithmonë kanë mbështetje në folklorin shqiptar. Ai ka shkruar disa vepra për saksofon, siç janë: "Concertino" për piano dhe orkestër, "Folk-Suita" për 2 saksofona e piano, kuarteti i sakos etj.

Beqiri lindi më 1967 në Mitrovicë, në një familje muzikantësh. Midis kompozimeve të krijuara deri më tani, dallohen: "Kuarteti Harkor", "AIBalkanika" koncert për saksofon e orkestër, "Shpirti i traditës" për timpan e orkestër harkore etj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit në fund të orës njihen me dinamikën (shpejtësinë) e muzikës klasike, si dhe literaturën e saj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hulumton për instrumentin muzikor.